



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 2.7.2019

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 2.7.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, konfirmuar në detyrë me anë të vendimit nr. 32/2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja dhe zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit!

Komisioneri Publik, në referencë të nenit C, pika 2 dhe F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, pasi vlerësoi se vendimi nr. 32/2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk është në pajtueshmëri me provat e administruara dhe është rrjedhojë e një hetimi administrativ jo të plotë, vuri në lëvizje juridiksionin kontrollues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Mbi bazën e shkaqeve të ankimit, kërkimeve dhe propësimeve të palëve, pranimit dhe vlerësimit tërësor të provave gjatë hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor të Kolegjit, zhvillimi i këtij gjykimi vijoi në respektim të dispozitave kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, e në çdo rast subjektit të rivlerësimit iu garantua e drejta për një proces të rregullt ligjor, si dhe iu dha mundësia të provonte të kundërtën¹ për secilin shkak ankimi.

Në vlerësim të Komisionerit Publik, ajo që rezultoi nga shqyrtimi gjyqësor i Kolegjit është se, për kontrollin e kriterit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti që, me prova dhe argumente bindëse, të provojë të kundërtën, si dhe nuk rrëzoi asnjë prej shkaqeve të ankimit.

Ky fakt provohet edhe nga treguesit e analizës financiare, të kryer nga ana e Kolegjit, paraqitur në seancën e datës 22.5.2019, nga e cila rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur burime financiare të mjaftueshme, të ligjshme, për të justifikuar krijimin e pasurisë, të ardhurave dhe kursimet e deklaruara.

Sikundër kemi mbajtur qëndrim, treguesit e analizës financiare, të kryer nga Kolegji, paraqiten negativë, dhe duke veçuar disa vite, në të cilat deklarohen kursime *cash*, hua, dhurim dhe blerje pasurie, konstatojmë se:

- (i) *Për vitin 2014*, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* në shumën 1.1 milionë lekë, subjekti rezulton në pamundësi dhe me mungesë të burimeve financiare

¹ Sipas nenit Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, “Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal”.

të ligjshme, për një diferencë negative në shumën – **607.505 lekë** (gjashtëqind e shtatë mijë e pesëqind e pesë lekë);

(ii) *Për vitin 2015*, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit deklaron blerjen e pasurisë apartament në Tiranë dhe deklaron sërish kursime *cash* në shumën 1.1 milionë lekë, subjekti rezulton në pamundësi dhe me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për një diferencë negative në shumën – **1.444.602 lekë** (një milion e katërqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e dy lekë);

(iii) *Për vitin 2016*, diferenca negative rezulton në shumën - **2,768,193 lekë** (dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre lekë). Kujtojmë se në këtë vit, subjekti deklaron se ka shlyer huan ndaj personit tjetër të lidhur, tezes së saj, në shumën 25.000 euro, me burim kursimet *cash* të deklaruara në vitet e sipërcituara, 2014 dhe 2015, si dhe shuma prej 1.8 milionë lekë, e deklaruar si dhurim nga personi tjetër i lidhur, nëna e subjektit të rivlerësimit.

Sa më sipër, provohet se subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi dhe me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara, e të cilat më pas (shuma 1.7 milionë lekë) kanë shërbyer për shlyerjen e huas.

Në vështrim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i njëjti fakt rezulton edhe për “*familjen Brati*”, lidhur me ligjshmërinë e burimit të deklaruar për shumën e dhuruar prej 1.8 milionë lekësh, shumë kjo e cila është përdorur për shlyerjen e huas 25.000 euro. Hua kjo e marrë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2015 dhe e deklaruar si e shlyer plotësisht në vitin 2016.

Duke përfunduar për sa parashtruam, në konsideratë të shkaqeve të ankimit dhe fakteve të provuara nga shqyrtimi gjyqësor i Kolegjit, Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë dhe likuiditetet e deklaruara, rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve D, Ç dhe F të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, përfundimisht, kërkojmë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit:

- Ndryshimin e vendimit nr. 32, datë 5.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA